



UNMIK/REG/2005/42
30 gusht 2005

RREGULLORE NR. 2005/42

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË NDRYSHUAR TË UNMIK-UT
NR. 2004/2 MBI PENGIMIN E LARJES SË PARAVE DHE VEPRAVE TË
NGJASHME PENALE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 (1999) të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke ditur se larja e parave kërcënon zhvillimin ekonomik të Kosovës, sundimin e ligjit, sigurinë, stabilitetin dhe se i kontribuon një atmosfere që është e përshtatshme për krim të organizuar, për korrupsion dhe për terrorizëm,

Pas shpalljes së Rregullore së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2004/2 të datës 5 shkurt 2004 për pengimin e larjes së parave dhe veprave të ngjashme penale,

Me qëllim të zgjatjes së periudhës së mbetjes në fuqi të Rregullore së ndryshuar të UNMIK-ut nr. 2004/2,

Me anë të kësaj shpall si vijon:

Neni 1
Ndryshimi

Që nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, neni 19 i Rregullore së UNMIK-ut nr. 2004/2 ndryshohet si në vijim:

“Përveç rasteve kur një datë e mëvonshme e plotfuqishmërisë shprehimisht parashihet në nene të veçanta, kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 mars 2004 dhe mbetet në fuqi deri më 28 shkurt 2006. Pas shqyrtimit kjo periudhë mund të vazhdohet nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.”

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 30 gusht 2005.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm